



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 2610 prot.

Tiranë, më 12. 11.2020

**URDHËR**

Nr. 98, datë 12. 11.2020

**“PËR**

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VAZHDIMIN E TRAJTIMIT TË ANKESAVE APO PRAKTIKAVE TË PËRCJELLA NGA KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR PRANË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të nenit 204, pika 1, shkronja “c” dhe të nenit 283, pika 11, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga data 01.02.2020, është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në funksion të përmbushjes së detyrave kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka dhënë përparësi dhe vëmendje administrimit dhe trajtimit të ankesave të depozituara gjatë periudhës transitore 2017-2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për realizimin e procesit, është ngritur grupi i punës, i cili në zbatim të urdhrit nr. 66, datë 28.09.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ka hartuar raportin përfundimtar “Mbi evidentimin e ankesave të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Bazuar në evidentimin e sjellë nga raporti, del në pah nevoja për vendosjen e një mënyre trajtimi, duke përcaktuar përparësitë në trajtimin e këtyre praktikave në vazhdimësi nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të parimit të ligjshmërisë, deburokratizimit, eficiencës, si dhe me qëllim zhvillimin e një procedure administrative në mënyrë sa më të shpejtë dhe efektive,

nëpërmjet këtij urdhri synohet vijimësia e shqyrtimit të ankesave, në zbatim të parimit të vazhdimësisë institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve të shtetit të së drejtës, lidhur me trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për këto arsye,

### **U R D H Ë R O J:**

1. Ngritjen e grupit të punës për rivlerësimin dhe trajtimin paraprak të ankesave apo praktikave të kategorizuara të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, më përbërje si më poshtë:

- a) Znj. Besmira Hysenbelliu, Kryetar;
- b) Znj. Ilma Bici, anëtar;
- c) Znj. Viktoria Spiro, anëtar;
- d) Znj. Elisa Mezini, anëtar;
- e) Znj. Ornela Shurdhaj, anëtar;
- f) Z. Nertil Kanina, anëtar;
- g) Z. Andi Guma, anëtar.

2. Me qëllim përshpejtimin e trajtimit të ankesave apo praktikave, grupi i punës do t'i rivlerësojë ato duke i evidentuar me përparësi referuar fazës ku janë, sipas kategorive vijuese:

- a) Ankesat dhe praktikat ku është propozuar apo ka filluar hetimi disiplinor;
- b) Ankesat në fazën e verifikimit apo në fazën e hetimit drejtuar gjyqtarëve që janë në detyrë, në të cilat parashtrihen pretendime për veprimtari deri në 1 vit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit të shkeljes disiplinore;
- c) Ankesa në fazën e verifikimit dhe të pezulluara, deri në pritje të përfundimit të gjykimit për çështjen konkrete nga gjykata më e lartë;
- d) Ankesat drejtuar ndaj gjyqtarëve të cilëve u ka mbaruar statusi i magjistratit, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- e) Ankesat drejtuar subjekteve të tjerë, veprimtaria e të cilëve nuk është objekt verifikimi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

3. Personi përgjegjës për Arkiv-Protokollin regjistron ankesat apo praktikat në librin e protokollit sipas rradhës së përparësisë të përcaktuar në pikën 2, të këtij urdhri dhe nën koordinimin e Kryetarit, i'a shpërndan në mënyrë të barabartë grupit të punës, kundrejt nënshkrimit pranë librit të dorëzimeve.

4. Pas rivlerësimit të përparësisë sipas pikës 2 të këtij urdhri, Inspektori përgjegjës i mbështetur nga grupi i punës harton projektvendimin përkatës duke i'a përcjellë për shqyrtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili merr vendimin përfundimtar për trajtimin e praktikës në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

5. Ngarkohet grupi i punës dhe personi përgjegjës për Arkiv – Protokollin për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri brenda muajit dhjetor 2020.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**

